



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:081237

Datë: 28.06.2024

KPPP.nr.458/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “QTA” SHPK, me seli në Mitrovicë, rr. “Dëshmorët e Kombit” pn, me autorizim e përfaqëson avokate Blerta Shyqeriu me seli në Fushë Kosovë, rr.”Metush Krasniqi” nr.22/17, kundër debitorit “THE NORTH UNICORN L.L.C” SHPK, me seli në Prishtinë, Zona Industriale, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.25/22 të datës 16.03.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fatos Shatri me seli të zyrës në Pejë, jashtë seancës, me datë 24.06.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “THE NORTH UNICORN L.L.C” SHPK, ashtu që Urdhri P.nr.25/22 i datës 16.03.2022, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Fatos Shatri MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr.25/22 i datës 16.03.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.6-2/70740 të datës 16.12.2021, faturës nr.6-2/70739 të datës 16.12.2021, faturës nr.6-2/70850 të datës 17.12.2021, faturës nr.6-2/71028 të datës 22.12.2021 dhe faturës nr.6-2/71104 të datës 24.12.2021 duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit

të urdhrorit, t'ia paguajë kreditorit borxhit 13,048.40 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore sipas tarifës së përmbartuesve, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrorit të Përmbartuesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se dokumentet në bazë të të cilave është marr urdhri përmbartues nuk janë të përshtatshme për përmbartim sepse tri nga faturat nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga debitori më saktësisht faturat nr.6-2/70850 e datës 17.12.2021, nr.6-2/71028 e datës 22.12.2021 dhe nr.6-2/71104 e datës 24.12.2021. Më tej ka theksuar se nëse mbledhet vlera e faturave që përmbajnë nënshkrimin dhe vulën, del se vlera totale arrijnë 8,769.97 Euro, ndërkaq nëse kësaj vlere i zbritet vlera e pagesave të bëra para inicimit të procedurës përmbartimore (1,947.71 Euro) dhe pagesës së bërë pas inicimit të procedurës përmbartimore (150 Euro), del se borxhi për kreditorin nuk e tejkalon vlerën prej 6,672.26 Euro. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të themeltë Prapësimin e debitorit, të shfuqizoj Urdhrin Përmbartimor P.nr.25/22 dhe të obligoj kreditorin që t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimin në vlerë prej 156.00 Euro, sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimi për përmbartim ka filluar duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm – faturat e verifikuara në librat afariste siç e përcakton edhe LPP fillimin e procedurës përmbartimore në bazë të nenit 29 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe neni 40 paragrafi 1, ndërsa në prapësim debitori ka theksuar se propozimi për përmbartim është iniciuar në bazë të faturave të cilat nuk i plotësojnë kushtet ligjore e këtë pretendim kreditori e kundërshton duke u bazuar në provat shtesë që janë dëshmitë mbi pranimin e mallit të lëshuar nga blerësi (debitori) dhe dëshminë e barazimit të kartelave për vitin 2021 të lëshuara nga blerësi (debitori) si dhe konfirmimin nga ana e kreditorit, ka kërkuar nga Gjykata që të refuzoj në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit, të vërtetoj Urdhrin Përmbartimor P.nr.25/22 dhe të detyroj debitorin të paguaj shpenzimet e paraqitjes së përgjigjes në prapësim në shumën prej 208 Euro sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme: faturës nr.6-2/70740 të datës 16.12.2021, faturës nr.6-2/70739 të datës 16.12.2021, faturës nr.6-2/70850 të datës 17.12.2021, faturës nr.6-2/71028 të datës 22.12.2021 dhe faturës nr.6-2/71104 të datës 24.12.2021, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimit të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.458/23, me datë 24.06.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.